

**Fjala e mbajtur nga Kryetari i Prezencës së OSBE-së,
Ambasadori Bernd Borchardt**

**Konferenca për teknologjitë e reja të votimit
Tiranë, më 13 Dhjetor 2017**

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë, ambasadorë, të nderuar miq.

Është kënaqësi t'ju mirëpres sot në këtë konferencë të nivelit të lartë për Teknologjitë e Reja të Votimit me partnerët tanë afatgjatë, përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë, bashkëkryetarët e Komisionit Ad Hoc për Reformën Zgjedhore të ngritur së fundmi, përfaqësues të partive politike parlamentare dhe joparlamentare, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ekspertët zgjedhorë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Përpara se të fillojmë, do të doja të falënderoja komisionin e posaçëm dhe anëtarët e tij që na shtynë ta organizojmë këtë veprimtari, si dhe veçanërisht Këshillin e Evropës dhe Ambasadën e Suedisë që e mbështetën.

Komisioni i posaçëm sapo ka filluar punë. Për ne në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri të ofruarit e mbështetjes për reformat zgjedhore është një traditë e gjatë dhe një nga shtyllat kryesore të punës sonë është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Jemi të gatshëm të ndihmojmë Komisionin dhe i nxisim fort të zbatojnë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe ta bëjnë këtë qëllim kryesor të punës së Komisionit.

Kjo nxitje nuk i drejtohet vetëm Komisionit të Posaçëm. Raporti i fundit për zgjedhjet e qershorit theksoi nevojën për veprime solide për të trajtuar çështjen e blerjes së votës dhe abuzimit me burimet shtetërore, edhe me ndjekje penale. Në këtë aspekt, teknologjitë e reja të votimit nuk mund të ndihmojnë shumë. Ne mirëpresim faktin që prokuroria ka hapur çështje për abuzimin me burimet shtetërore dhe ne i bëjmë thirrje prokurorisë të ndjekë edhe rastet e ditura të blerjes së votës.

Disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së po përdorin teknologjitë e reja, ndërsa disa të tjera e kanë ndaluar përdorimin e tyre dhe i janë kthyer metodave zgjedhore të bazuara te letra. Madje, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë arriti deri aty sa t'i ndalonte teknologjitë e reja të votimit si jotransparente. Prandaj, duhet të diskutojmë gjerë e gjatë për të mirat dhe të këqijat e teknologjive të reja të votimit.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që filluan të përdorin teknologjitë e reja të votimit e bënë këtë për shkak të potencialit të tyre: rritjes së pjesëmarrjes së votuesve, përfshirjes së qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, kostos më të ulët të administratës zgjedhore në planin afatgjatë, përmirësimin e saktësisë së numërimit. Megjithatë, përfitimet janë vetëm të mundshme dhe sigurisht që përdorimi i teknologjive të reja të votimit për zgjedhjet është kompleks dhe i shtrenjtë. Për të mos përmendur se proceset demokratike janë të fundit që ne

do të dëshironim të shihnim nën sulme kibernetike. Ka rreziqe në përdorimin e teknologjive të reja të votimit dhe të gjitha duhet të merren parasysh. Teknologjitë e reja të votimit nuk mund të krijojnë besim dhe nuk mund të zëvendësojnë besimin të sistemi zgjedhor. Por unë ju rekomandoj të shqyrtoni numërimin elektronik, i cili nuk do të kërkonte shpenzime financiare të pamasa, do të ishte *offline*, pra nuk do të sulmohej lehtë nga piratët e kibernetikës, si dhe mund të kontribuonte në depolitizimin e një pjese të administratës zgjedhore.

Në konferencën e sotme, ne do të shohim më afër kontekstet e ndryshme në të cilat janë aplikuar teknologjitë e reja të votimit. Ne do të diskutojmë për besimin e publikut të zgjedhjet si bazë për teknologjitë e reja të votimit, nevojën për t'i testuar ato përpara se të vihen në përdorim përmes projekteve pilote dhe nevojën për informim të mjaftueshëm publik, edukimin e zgjedhësve dhe trajnim të stafit të zgjedhjeve.

Besoj se kjo është koha e duhur për të diskutuar aplikimin potencial të teknologjive të reja në zgjedhje, sepse ka ende mjaft kohë deri në zgjedhjet e ardhshme, por vendimet duhet të merren shpejt. Gjithashtu, dua të nënvizoj se është se është e domosdoshme të vijojmë të kemi në fokus rekomandimet e tjera të ODIHR-it për zgjedhjet e fundit dhe ato të mëparshmet. Çështjet në lidhje me perceptimet për blerjen e votës, financimin e fushatës, ndjekjen penale të rasteve të shkeljeve në zgjedhjeve të denoncuar në Polici dhe Prokurori, si dhe administrimi profesional i zgjedhjeve, duhet të jenë çështje prioritare, dhe jo vetëm në punën e Komisionit të Posaçëm.

Autoritetet shqiptare duhet që të shqyrtojnë me kujdes opsionet për çdo zbatim të ardhshëm të teknologjive të reja të votimit. Për këtë arsye, rekomandimet dhe konkluzionet e kësaj konference do t'i paraqiten Kuvendit të Shqipërisë.

Nga ana jonë në OSBE, ne jemi të gatshëm të vijojmë të japim mbështetjen tonë për proceset e reformës zgjedhore dhe për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të legjislacionit përkatës.

Shumë faleminderit për vëmendjen!